



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr.225/2024
Datë:19.09.2024

Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyrtari i Inspektimit, duke vepruar në pajtim me nenin 68, nenin 69, paragrafi 1, dhe nenin 71, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.2, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të njoftimit të pranuar me më datë 26.07.2024, dhe të regjistruar me nr. Protokolli 624, ndaj “Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ” në Gjakovë, në cilësinë e kontrolluesit nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Urdhërohet “Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare” me adresë, Rr. Beqir Kastrati në Gjakovë, në cilësinë e kontrolluesit, që të nxjerr vendimin lidhur me instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë.
2. Obligohet kontrolluesi, që të vendos shenjat njoftuese për vëzhgimin me kamerë, sipas kriterëve të parapara me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Këshillohet kontrolluesi, që sistemin e vëzhgimit me kamerë ta aplikoj sipas dispozitave ligjore të parapara me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Obligohet kontrolluesi, që brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga pranimi i këtij vendimi të ndërmerr të gjitha veprimet e duhura për zbatim të këtij vendimi dhe ta njoftoj Agjencinë për Informim dhe Privatësi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia), më datë 26.07.2024, ka pranuar njoftim përmes postës elektronike (*e-mail*) që mbanë nr. prot.624, të parashtruar nga subjekti i të dhënave personale i cili paraqet shqetësimin, në lidhje me atë se në Urgjencën e “Qendrës

Kryesore të Mjekësisë Familjare” në Gjakovë, ka qasje të pa autorizuar në sistemin e vëzhgimit me kamerë, Drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunë të Gjakovës.

Andaj bazuar në nenin 68 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), zyrtarët inspektimit nga Agjencia më datë 20.08.2024, kanë realizuar inspektim në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjakovë për të mbikëqyrur se nga kush kontrollohen kamera, personat përgjegjës që kanë qasje në sistemin e vëzhgimit me kamerë, nxjerrja e vendimit për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë dhe a është njoftuar stafi në lidhje me instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë.

Gjatë inspektimit është konstatuar se nga ana e kontrolluesit qasje në kamera ka vetëm zyrtari i teknologjisë informative, kamerat mbikëqyrin korridoret dhe hyrjen e QKMF-së, nuk ka të nxjerr vendim për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë, nuk ka të vendosura shenja paralajmëruese të vëzhgimit me kamerë, ruajtja e incizimeve nga ana e vëzhgimit me kamerë është katërmbëdhjetë (14) ditë.

Gjithashtu përmes postës elektronike me datë 27.08.2024, për trajtimin e lëndës është kërkuar nga ana e Drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunë të Gjakovës, që të na njoftoj se kush ka qasje në kamerat e sigurisë në objektin e urgjencës dhe QKMF-së, a keni nxjerr vendim për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë si dhe cilët janë personat kompetent të cilës kanë qasje në sistemet e vëzhgimit me kamerë.

Po të njëjtën ditë kemi pranuar përgjigje se monitorimi në institucionet e KPSH, behët që nga viti 2020, dhe gjinden aparaturat në serverin kryesor në QKMF (dhoma IT - ka qasje vetëm IT) gjithashtu qasje bëhet vetëm nga ana e zyrtarëve përgjegjës të TI-së brenda QKMF-së.

Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP) përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Sipas nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, me të “dhëna personale” nënkuptojmë çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm, një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik. Gjithashtu nën paragrafi 1.11, i LMDhP- së, ka dhënë përkufizimi e shprehjes “kontrollues i dhënave” është çdo person fizik apo juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale. Andaj, sipas këtij përkufizimi “Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare” Gjakovë, cilësohet kontrollues i të dhënave.

LMDhP-ja në nenin 4, parasheh parimet themelore për përpunimin e të dhënave personale që duhet respektohet me rastin e përpunimit të të dhënave personale. Njëri ndër këta parime është parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës, në bazë të të cilit të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave.

Në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së individit, vëzhgimi me kamerë nënkupton marrjen dhe ruajtjen e të dhënave vizuale ose të tjera nga vendet e vëzhguara, ku personat fizikë lëvizin apo edhe qëndrojnë.

Për më tepër, vëzhgimi me kamerë nënkupton përpunimin e të dhënave personale gjatë regjistrimit të një personi fizik, në përputhje me përkufizimin e përpunimit të të dhënave personale të parashikuara në LMDhP. Kur kemi të bëjmë me përpunimin e të dhënave personale, LMDhP në dispozitat e tij ka dhënë kuptimin se cilat veprime konsiderohen si përpunim i të dhënave personale, gjegjësisht neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LMDhP-së, përcakton se me “përpunim” nënkuptojmë çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi. Në kuadër të kësaj dispozite, nënkuptojmë se mbledhja dhe regjistrimi i imazheve të marra nga sistemi i vëzhgimit me kamerë, përbënë përpunim të të dhënave personale dhe si i tillë, ky përpunim duhet të bëhet në mënyrë të ligjshme.

Neni 75 paragrafi 2, të LMDHP-së, ka përcaktuar se personat që kanë për qëllim të vendosin sistemin e vëzhgimit me kamerë duhet të vendosin njoftim për këtë (shenjë paralajmëruese), i cili duhet të jetë i dukshëm dhe të bëhet publik në mënyrë që t’iu mundësojë subjekteve të të dhënave, që pa vështirësi, të njoftohen me masat, më së voni kur të fillojë vëzhgimi me kamerë dhe ky njoftim duhet të përmbajë të dhënat me të cilat do të identifikohet kontrolluesi i të dhënave. Gjithashtu ky njoftim duhet të përmbajë qëllimin e vendosjes dhe kohëzgjatjen e ruajtës së regjistrimeve.

Neni 76, i LMDhP-së, përcakton se personat në sektorin publik dhe privat mund të instalojnë sistemin e vëzhgimit me kamerë për vëzhgimin e ndërtesave të tyre nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurinë e pasurisë. Vëzhgimi me kamerë, në veçanti, mund të jetë i nevojshëm për të vëzhguar hyrjet e ndërtesave ose ku për shkak të natyrës së punës së tyre, ekziston kërcënimi potencial ndaj të punësuarve.

Për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë, duhet merret vendim nga nëpunësi kompetent, drejtori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga sektori privat, i cili vendim duhet të përmbajë arsyet për vendosjen e sistemit të vëzhgimit me kamerë. Regjistrimet e sistemit të vëzhgimit me kamerë mund të ruhen deri në (1) muaj, përveç nëse nuk kërkohet ndryshe për qëllime legjitime.

Andaj, nga kjo që u tha më lartë, bazuar në faktet e sipërpërmendura si dhe LMDhP-në, Agjencia konstaton se “Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare” Gjakovë, (në cilësinë e kontrolluesit) përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë ka përpunuar të dhëna personale në kundërshtim me nenin 75 dhe 76 të LMDHP-së, pasi që e njëjta nuk ka vendim për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë si dhe nuk ka të vendosur shenjën njoftuese për aplikimin e vëzhgimin me kamerë.

Agjencia për Informim dhe Privatësi pas inspektimit të kryer dhe vërtetimit të gjendjes faktike, bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

[Nënshkruar më datë 19.09.2024]

Zyrtar për Inspektim

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. “Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare” Gjakovë,-Kontrolluesit
2. Arkivit të Agjencisë.